Shkruaj, sepse pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, asgjë nuk del prej saj, përveç së vërtetës.”

Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) ka thënë: "Shkruaja çdo gjë që dëgjoja nga i Dërguari i Allahut ﷺ, që doja ta mësoja përmendsh, por kurejshët më ndaluan dhe më thanë: "A po shkruan gjithçka që dëgjon nga i Dërguari i Allahut ﷺ, kur ai është njeri: flet në gjendje hidhërimi dhe kënaqësie?" Kështu, hoqa dorë nga shkrmi dhe ia përmenda këtë gjë të Dërguarit të Allahut ﷺ, e ai bëri me gisht nga goja e tij dhe tha: “Shkruaj, sepse pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, asgjë nuk del prej saj, përveç së vërtetës.”

[Sahih] [Transmeton Ebu Davudi]

Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) ka thënë: Gjithçka që dëgjoja nga i Dërguari i Allahut ﷺ e shkruaja për ta ruajtur me shkrim, por disa nga kurejshët më ndaluan e më thanë: "I Dërguari i Allahut ﷺ është njeri që flet në gjendje kënaqësie e hidhërimi dhe mund të gabojë", kështu që ndalova së shkruari. Kështu, i tregova Profetit ﷺ se çfarë thanë, e ai bëri me gisht nga goja e tij dhe tha: "Shkruaj se, pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, nuk del asgjë prej saj, përveç së vërtetës në çdo situatë; qoftë kënaqësi, qoftë zemërim! Allahu i Lartësuar për Profetin e Tij ﷺ thotë: "Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij." (En Nexhm, 3-4)

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/65077